



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislacioni IV  
Sesioni vjeshtor  
Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 39  
Prishtinë, më 25 shtator 2012, në orën 11:30  
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

**P r o c e s v e r b a l**

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi dhe Amir Ahmeti.

**Mungoi:** Shaip Muja, Skender Hyseni dhe Petar Miletqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Florie Mehmeti - KDI, Drilon Gashi – D4D, Blerim Dervishi e Besarta Zuka – NDI dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi** Albin Kurti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**R e n d d i t e:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 4 dhe 12 shtator 2012;
3. Takim me studentët e Universitetit të Cambrigde nga Britania e Madhe;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.*

**2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 4 dhe 12 shtator 2012;**

*Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 4 dhe 12 shtator 2012, me vërejtjen që në procesverbalin e datës 4 shtator 2012 fjalët “ngase janë shumë të ngarkuar dhe se mendojnë që i takon sekretarisë që ta organizojë një takim në vitin e ardhshëm” duhet të zëvendësohen me fjalët “mbase mund ta bëjnë vitin e ardhshëm dhe sekretarit tona le ta organizojnë atë takim”.*

**3. Takim me studentët e Universitetit të Cambrigde nga Britania e Madhe;**

**Albin Kurti** - Fillimisht prezantoi anëtarët e Komisionit. Në fjalën hyrëse të tij theksoi se nga shpallja e pavarësisë, Kosovën e kanë njohur rreth gjysma e shteteve të botës, në mesin e të cilave edhe 22 vende të BE-së. Ndër sfidat e Kosovës theksoi mungesën e integritetit territorial, si pasojë e obstrukcioneve të Serbisë e cila përmes strukturave të saja ilegale dëshiron të ketë kontroll në territorin e Kosovës dhe mungesën e zhvillimit ekonomik të Kosovës, e cila ka ndikuar që Kosova të jetë vendi më i varfër në Evropë dhe me një papunësi shumë të madhe.

Ai shtoi se, ne jemi të interesuar për marrëdhënie bilaterale me shtetet që e kanë njohur Kosovën, në fushën e ekonomisë, arsimit e kulturës. Populli i Kosovës është popull paqësor, i durueshëm, i cili ka vuajtur më së shumti në ish- Jugosllavi. Ka vuajtur edhe shumë kohë para luftës dhe ka pasur shtypje politike, shfrytëzim ekonomik e deri te aparteidi i viteve të 90-ta, të kohës së Millosheviqit. Ne dëshirojmë të integrohemi në BE dhe në NATO, dhe jemi të gatshëm për bashkëpunim me të gjitha shtetet të cilat na kanë njohur.

**Hydajet Hyseni** – E falënderoi shtetin e Britanisë së Madhe për njohjen dhe ndihmën që ia ka ofruar Kosovës. Theksoi vullnetin e përgjithshëm që mbretëron për ta bërë Kosovën vend të zhvilluar e demokratik dhe storie të suksesit të përbashkët të vendorëve dhe faktorëve ndërkombëtarë që e kanë mbështetur pavarësinë e Kosovës.

**Studentët e Universitetit Cambrige nga Britania e Madhe** kërkuan të informohen për dallimet e partive politike lidhur me zhvillimet në Kosovë dhe rajon; se cila do të ishte ndihma e mëtejme ndërkombëtare ekonomike që do t'i duhej Kosovës; cila është strategjia që ta njohin Kosovën edhe pesë vende të tjera të BE-së; cila është qasja ndaj çështjes së Qipros Veriore e Spanjës; cili është qëndrimi ndaj euros dhe cilat do të ishin implikimet nëse do të kalohej në valutë kombëtare, çfarë janë marrëdhëniet me Kinën dhe Vietnamin; cila është sfida më e madhe për t'i balancuar raportet me Rusinë, në raport edhe me perëndimin?

**Albin Kurti** - Duke u ndërlidhur me çështjet e parashtruara nga studentët britanikë tha se kemi dallime në mes subjekteve politike, mirëpo kemi edhe mjaft çështje të përbashkëta, si integrimi evropian, sovraniteti, integriteti territorial etj. Dallime politike dhe ideologjike tha se kemi sa i përket privatizimit dhe negociatave me Serbinë. Si lëvizje, jemi kritik edhe ndaj EULEX-it, sepse ata nuk janë këtu për të na zhvilluar, por janë mbi ligjin dhe kanë pushtet ekzekutiv. KFOR-i, UNMIK-u, OSBE e EULEX-i, tha se janë organe të ndryshme të protektoratit ndërkombëtar që janë sipër institucioneve tona. Theksoi se kemi përkrahur ndërhyrjet e NATO-s, në Kosovë, sepse na ka mundësuar që të çlirohemi nga gjenocidi serb, mirëpo pas çlirimit nuk patëm një demokraci të vërtetë.

Bashkësia ndërkombëtare ka gabuar me ne, duke mos caktuar një mandat të qartë për të zhvilluar vendin, për të ndërtuar institucione të forta. Ajo është këtu për të menaxhuar krizën dhe në vend që të na krahasojnë me shtete normale na krahasojnë me shtetet si Afganistani ose Palestina. Sa i përket valutës tha se ne nuk kemi kërkuar që ta marrim monedhën euro, por me të dalë nga lufta ju kemi bashkangjitur asaj. BE-ja do të duhej të sillte në Kosovë profesorë, doktorë, ekspertë të bujqësisë, e jo policë e gjykatës dhe prokurorë që të na disiplinojnë dhe të kenë imunitet ndaj ndjekjes penale. Ne kërkojmë një qasje moderne të BE-së, që të na ndihmojë të jemi pjesë e BE-së. Për raportin me Kinën dhe Vietnamin tha se, si vendi më i varfër në Evropë dhe me tregun më liberal eksportojmë dhe importojmë, mirëpo 1:11 është raporti në mes eksportit dhe importit.

Sa i përket Rusisë, tha se Serbia ka qenë fëmija i Rusisë qysh prej shekullit të XIX-të dhe e po mundohet të luajë me të dy kartat edhe me Moskën edhe me Brukselin. Lidhur me pesë shtetet e BE-së që nuk na kanë njohur tha se, takohemi me këto shtete në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, ju shkruajmë letra, mirëpo ato kanë disa probleme të brendshme të tyre. Megjithatë

këto shtete që kanë probleme të ngjashme me Kosovën, nuk do të duhej ta krahasonin vetën me Serbinë, sidomos me Serbinë e Millosheviqit.

**Sabri Hamiti** - Theksoi se nuk është në favorin tonë mosnjohja ende nga pesë shtete të BE-së, pasi që politika e jashtme e BE-së bëhet me konsensus dhe këto shtete po e diktojnë agjendën politike të BE-së, për Kosovën. Nuk është mirë që Kosova të krahasohet me krahinat e brendshme të këtyre shteteve ngase Kosova e ka fituar pavarësinë me shpërbërje sikurse Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Maqedonia dhe Mali i Zi dhe nuk beson se shtetet në fjalë janë të interesuara që të ngrehin paralele krahasimi me Serbinë e Millosheviqit. Çështja e mosnjohjes qëndron përtej problemeve të brendshme, ngase po të shikohet harta e Evropës nga veriu në jug është një bllok ortodoks i shteteve që nuk e njohin Kosovën, kjo lidhet me një nacionalizëm fetar ortodoks, në krye me Rusinë. Shqiptarët i kanë tri konfeksione fetare dhe se nuk mund të gjendet asnjë komb si shqiptarët që ka më shumë harmoni fetare. Shprehu besimin se vendet e BE-së që e kanë njohur Kosovën, do të kenë ndikimin në vendet që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Partitë politike në Kosovë kanë dallime, por politika e përbashkët nacionale është integrimi në BE.

**Enis Kervan** - Tha se komuniteti turk dhe komunitetet e tjera në Kosovë i kanë të gjitha të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me ligje. Probleme ekzistojnë kryesisht në zbatueshmërinë e ligjeve, sepse ende jemi një shtet i ri. Duke cekur numrin e banorëve turq në Kosovë theksoi se, njohja e Kosovës nga shtetet që ende nuk e kanë njohur Kosovën nuk është njohje vetëm për shqiptarët, por edhe për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

**Donika Kadaj-Bujupi** -Tha se ekziston një perceptimin i gabuar për Kosovën, i cili mund të jetë edhe si pasojë e shërbimeve të dobëta diplomatike të saja. Njerëzit nga jashtë zakonisht na shohin si një vend ku ka shumë krim, mungesë të stabilitetit dhe ku është e pamundur të investohet, si rrjedhojë e propagandës që vjen nga Serbia, në dëm të Kosovës. Ne mundohemi të reagojmë dhe të tregojmë se rrethanat kanë ndryshuar, dhe agjenda kombëtare për Kosovën është integrimi në BE. Një ndër problemet tona tha se është zhvillimi ekonomik dhe papunësia e madhe, përderisa kemi kapitalin njerëzor që mundet me qenë një resurs pozitiv për Evropën. Në Kosovë tha se nuk ka pasur ndonjë investim të madh e serioz, investime ka pasur në formë të ndihmës. Lidhur me liberalizimin e vizave, tha se po mundohemi t'i përmbushim obligimet tona, jo në mënyrë perfekte, mirëpo ashtu sikurse shtetet e rajonit, të cilat tashmë kanë liberalizim të vizave.

#### **4. Të ndryshme**

Kryetari i Komisionit njoftoi se çështje e paraparë në Planin e Programin e Punës së Komisionit është iniciativa për takim me kryetarët e komisioneve të jashtme të vendeve të rajonit. Ai, po ashtu, ceku se Komisioni ka planifikuar në këtë sesion edhe organizimin e një tryeze.

Pas diskutimit të deputetëve H. Hyseni dhe S. Hamiti, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

#### ***Përfundim***

*1. Të iniciohen përgatitjet për organizimin e takimit me kryetarët e komisioneve të jashtme të vendeve të rajonit.*

*2. Të iniciohet organizimi i tryezës së Komisionit për Punë të Jashtme.*

Takimi përfundoi në orën 12:35.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

-----

Albin Kurti

